

PËRSHKRIM RELACIONIT TEKNIK

OBJEKTI: "KAPANON 1 KAT"

**ADRESA: Rruga Durrës – Shijak, Stacioni Zootehnik Xhafzotaj, Njësia Administrative
Rrashbull, Bashkia Durrës**

Siperfaqe prone 1238 m²

Siperfaqe e tokës të zënë nga struktura 708 m²

Ne pronësi të z/ Elvis Ballanca

ZHVILLUESI: "Çipi Konstruksion" shpk

Mikel Çipi



ÇIPI KONSTRUKSION

NIPT: L322075050



Konstruksione Metalike

Mbulim me Panel Sanduic

Cel: 067 40 10 521

Shënvlash - DURRES

Procedura e Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis “Në plotësim të dokumentacionit
shtojca II pika 10.a

Projekte per zhvillimin e pasurive te patundshme industriale

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr. 10 440 date 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” dhe të VKM Nr.13 datë 4.4.2013 “ Për Miratimin e Rregullave, të Pergjegjësive dhe të afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis “Në plotësim të dokumentacionit, shtojca II pika 10.a

Projekte per zhvillimin e pasurive te patundshme industriale

po japim të dhënat e Projektit të Propozuar për Zhvillim të lartpërmendur

Objekti qe propozohet te ndertohet eshte “Kapanon 1 kat”

Ndodhet ne Zonen kadastrale Nr. 2574. Prona me Nr. Pasurie: 163/55 , 163/77 . Siperfaqja 1238 m2 . Me adrese S. Z Xhafzotaj, Durres.

KONDITIONET URBANE

Të dhëna teknike të aktivitetit

Sipërfaqja e tokes që do të zhvillohet..... 1238 M2
Siperfaqja e tokës e zëne nga struktura708 M2
Siperfaqja e përgjithshme e ndërtimit.....708 M2
Intensiteti i ndërtimit..... 0.57
Koeficienti i shfrytëzimit të territorit..... 57%
Lartësia maksimale e struktures nga niveli i kuotes se sistemuar 10 M
Numri i kateve mbi toke1 kat
Hyrja kryesore ne kapanon ngaJugu

Kufizimet e pasurise jane ne:

Veri kufizohet me Pasurine 163/54
Jug Kufizohet me pasurine 163/20
Lindje kufizohet me pasurine 163/56
Perendim kufizohet me pasurine 163/24

Kapanoni që do të ndërtohet duhet të ketë përputhje dhe konfiguracion të truallit dhe me kufizimet e pasurive dhe sipas hartës treguese dhe kufirit real të tij në terren.

Konstruksioni i kapanonit do të realizohet me themel plinta dhe trare lidhës b/a, trare dhe kollona metalike. Faqet anësore dhe mbulimi do të realizohen me panel sanduic. Ndricimi elektrik do të realizohet me ane të ndricuesve të posacem për ambiente kapanonësh.

Per ndertimin e kapanonit 1 katesh do te perdoret solet B/A me lartesi h= 20 cm

Tra themeli me 40X 60

Themel tip plimt me h=60 cm

Mbushje me cakull te ngjeshur me h= 20 cm

Mbushje me dhe te ngjeshur h=40 cm

Toke natyrale

Furnizimi me energji elektrike i Kapanonit 1 katesh do të realizohet nepermjet infrastruktures nentokesore të lidhur me nenstacionin elektrik me të afërt.

Punime betoni m-250. ----247 m³

Konstruksione metalike-----37543 m²

Punime veshje catie -----708 m²

Mbulim catie me panel sanduic 40

Veshje me panel sanduic -----1162 m

Ulluk shkarkimi horizontal 20 mm me llamarine ----96 m

Ulluk shkarkimi vertikale PVC -----80 m

Fashatura kendore ----260m

Prona është e lidhur me rrjetin e energjisë elektrike me linje nentokesore. Ndertësat me orientim banim janë përqendruar kryesisht në qendrat e banuara të fshatrave përreth.

Me gjithë zhvillimet intensive në sektorin e ndertimeve komerciale dhe industriale në zone vihen re ende sipërfaqe të lira tokash bujqësore, me tendencë për zhvillim.

Furnizimi me ujë të pijshëm është problematike e zonës dhe realizohet pjesërisht me ane të puseve të thella të shpimit të hapura në pronat e vecanta.

Pranë qendrave të banuara të fshatrave përreth ka rrjet ujësjelles, ndërsa furnizimi me ujë i ndertësive në afërsi të pronës që propozohet për ndertim është zgjidhur me ane të puseve.

Prona nuk bën pjesë në zonat e ndotura të territorit të Shqipërisë.

Objekti do të ndërtohet sipas Standarteve Shqiptare të ndertimit. Gjate ndertimit të objektit do merren parasysh disa faktore kryesore që janë destinacioni i zonës, pronësia e trojeve, plan

vendosja e objektit, zona turistike bregdetare, kondicionet urbane, formacionet gjeologjike dhe kerkesat higjeno-sanitare.

Gjithashtu do te merret parasysh kualiteti i zones se ndertimit, orientimi i vendosjes se objektit sipas planit urban ekzistues te Bashkise Durres.

Te gjithe materialet qe do te perdoren do te sistemohen brenda rrethimit. Mbetjet inerte te ndertimit qe do te krijohen gjate punimeve germuese dhe ndertuese do te largohen cdo dite per ne nje vend te vecante brenda objektit deri ne largimin perfundimtar te tyre.

Ndertimi i godines eshte llogaritur i tille qe do te marre ne konsiderate intensitetin sizmik te zones.

Skelat, mjetet e punes dhe materialet e ndertimit qe do te perdoren, nuk do te zene rruge te kalimit dhe pengojne punen ne njesite e tjera te sherbimet, perreth.

Distancat me objektet e tjera dhe rruget qe e kufizojne jane te pandryshueshme dhe brenda normave urbanistike.

Persa i perket proceseve ndertimore shkurtimisht sqarojme se ;

Do te kihet parasysh te respektohen te gjitha markat e betonit te specifikuara nga projektuesi, si dhe te gjitha kushteve teknike per realizimin e themeleve dhe karabinase. do te kihet parasysh mire edhe hidroizolimi i mire i kapanonit dhe sheshit perreth duke marre te gjitha masat ne menyre qe te mos behen objekt i grumbullimit te ujrave.

Persa i perket lidhjes me infrastrukturen te objektit mund te themi qe ne krye se kjo eshte nje zone qe ofron mundesi per infrastrukturen per godina industriale dhe sherbimi dhe si e tille ka mundesi per lidhje furnizim me uje, energji elektrike si dhe shkarkimin e ujrave te bardha dhe te zeza.

Vlen te permendet qe gjate gjithe fazave te punimeve si germim, transportit, betonimit, muratures, suvatimit etj do te kihet ne vemendje te vecante e gjithe problematika mjedisore sic jane edhe mbetjet te cilat do te evadohen ne kohen me te shpejte pa krijuar probleme per zonen. Ne perfundim te punimeve do te behet edhe sistemimi siperfaqes perreth i cili mendohet te jete i kombinuar me pllaka asfaltobetoni dhe me gjelberim

Ne vijim sipas te gjitha llogaritjeve tona ,grafikut te punimeve mendojme qe objekti do te ndertohet brenda 3 vjeteve pasi te marre lejen e ndertimit. Sigurisht qe objekti do te filloje punimet pasi te jete plotesuar me gjithe lejet e nevojshme sic jane leja mjedisore paraprake, leja e ndertimit etj. Pra do te respektohen te gjitha procedurat ligjore dhe teknike sipas legjislacionit ne fuqi si para fillimit te punimeve, por dhe gjate ndertimit dhe kolaudimit te objektit deri ne fazen e shfrytezimit nga investitori.

Zhvilluesi

“Çipi Konstruksion”shpk

Mikel

